1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

##### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

#### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës  
Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit



## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### **FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [**Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in**]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për *[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës*

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

**të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**(d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

**(e)** Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

**(f)** Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	



<b>Datë</b> _____	
-------------------	--

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**  
\_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për</b>	<b>Çmimi total</b>	

	<b>Ofertës Ekonomike</b>		<b>njësi</b>	<b>(3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					



**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]  
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

### **Nënshkrimi**

### **Vula**



## Shtojca 5.

(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

### DEKLARATË

#### Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt .....është i pamiraturar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

#### Shtojca 6.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet: “Hartimi i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit ”**

**Afatet e ekzekutimit: 6 (gjashtë ) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

**TERMAT E REFERENCËS DHE PËRLLOGARITJA E FONDIT LIMIT PËR  
HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT, BASHKIA TIRANË**

## PROCES VERBAL

Mbledhur sot më datë 03.10.2024 mbi bazën e Memos nr.15655 prot., datë 19.04.2024 me objekt: “Kërkesë për miratimin mbi ngritjes së grupit të punës për realizimin e shërbimit “Hartim i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”, si dhe Urdhërit të Zv/Kryetarit të Bashkisë Tiranë me nr. 2212 datë 07.08.2024 dhe nr. 15655/1 prot., datë 07.08.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit, konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit “Hartim i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”, përcaktimin e termave të referencës, grafikut të realizimit, si dhe përcaktimin e fondit limit për realizimin e tenderit për këtë objekt.

Çdo zhvillim dhe përgatitje e dokumentacionit është realizuar mbi bazën e eksperiencës së përgatitjes së dokumentacionit të cilësisë së ajrit si dhe Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit në nivel qendror.

## **PËRMBAJTJA**

### **1. FJALOR**

### **2.TË PËRGJITHSHME**

#### **2.1. Situata Aktuale e ajrit në territorin e Bashkisë Tiranë.**

### **3. DETYRAT**

#### **3.1. Detyrat që ndiqen për hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit.**

#### **3.2. Objektivat e përgjithshëm dhe specifikë të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit.**

### **4. QËLLIMI I PUNËS**

#### **4.1. Fazat që ndiqen për hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit.**

### **5. AFATI I HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

### **6. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

### **7. MONITORIMI I DETYRAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

### **8. MIRATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

### **9. REFERENCA LIGJORE**

## 1. FJALOR

Në këtë material janë përdorur përkufizimet si më poshtë:

Ajër i mjedisit	Është ajri i jashtëm në troposferë, që përjashton ajrin në vendet e punës, në mjediset e ndërmarrjes dhe/ose biznesit dhe çdo vend tjetër brenda tyre ku punonjësit hyjnë për shkak të punësimit të tyre e ku zbatohen dispozitat për shëndetin dhe sigurinë në punë e ku publiku nuk hyn rregullisht.
Ndotës	Është çdo substancë e pranishme në ajrin e mjedisit, që ka mundësi të ketë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin në tërësi.
Nivel	Është përqendrimi i një ndotësi në ajrin e mjedisit ose depozitimi i tij në sipërfaqe në një kohë të dhënë.
Monitorim	Monitorimi i cilësisë të ajrit është një komponent kryesor i çdo metode efektive të menaxhimit të cilësisë së ajrit, sepse siguron një dëshmi për vendimmarrësit në menaxhimin dhe përmirësimin e mjedisit tonë.
Burime difuze	“Ndotje e shpërndarë”, siç janë shkarkimet e autovecurave, kamionëve, autobusëve dhe automjeteve komerciale, si dhe nga oxhaqet e shtëpive dhe apartamenteve, e kanë origjinën nga burimet pikësore.
Burime pikësore	Janë burime stacionare të shkarkimeve të ajrit, si fabrika, termocentrale dhe përfshijnë të gjitha ato burime, për të cilat është e dobishme dhe kur është e mundur, të përcaktohen në mënyrë individuale koordinatat gjeografike dhe parametrat e shkarkimeve.



Vlerë kufi	Është niveli i caktuar që duhet arritur brenda një periudhe të caktuar dhe që kur është arritur nuk duhet kapërcyer, përtej të cilit përcaktohet dëmtues për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Vlera kufi përcaktohet në bazë të dijeve shkencore, me synim shmangien, parandalimin ose pakësimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut dhe/ose mbi mjedisin në tërësi.
------------	---

## 2. TË PËRGJITHSHME

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin që na rrethon, i cili vazhdimisht është nën ndikimin e ndotjes. Ndotja e ajrit pati një rënie të theksuar mbas ndryshimeve politike në fillim të viteve '90, si pasojë e mbylljes së aktiviteteve industriale më të rëndësishme të vendit që ishin njëkohësisht edhe burimet më potenciale të emetimit të ndotësve në ajër. Paralelisht me këtë fenomen lindi dhe u zhvillua një problem i ri mjedisor, ai i ndotjes në rritje të ajrit urban, kryesisht nga shkarkimet e automjeteve, aktivitetet e ndërtimit dhe keqadministrimi i mbetjeve të ngurta. Ndryshimet klimatike dhe ndotja e ajrit janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Ajri i ndotur ka efekte negative në shëndetin e njeriut dhe ekosistemet; në shtresën e sipërme të atmosferës, ajri i ndotur ndikon në klimën globale duke ndikuar në shtresën e ozonit, e cila na mbron nga efektet e dëmshme të rrezeve të diellit.

Zhvillimi urban, transporti, bujqësia, menaxhimi i mbetjeve, industria dhe pajisjet shtëpiake për ngrohje janë ndër sektorët kryesorë që ndikojnë drejtpërdrejt në ndotjen e ajrit. Të gjithë këta sektorë çlirojnë një shumëllojshmëri ndotësish, si: dioksid squfuri (SO<sub>2</sub>), oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>), monoksid karboni (CO), ozoni, benzen, plumb (Pb), si dhe lëndë grimcore (PM-PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>).

Nr.	Ndotësit	Përqëndrimi	Periudha mesatare	Tejkalimet e
-----	----------	-------------	-------------------	--------------

				<b>lejuara çdo vit</b>
<b>1.</b>	<b>Grimcat e imëta (PM2.5)</b>	25 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a
	<b>Grimcat (PM10)</b>	50 µg/m <sup>3</sup>	24 orë	35
	<b>Grimcat (PM10)</b>	40 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a
<b>2.</b>	<b>Dioksidi i squfurit (SO<sub>2</sub>)</b>	125 µg/m <sup>3</sup>	24 orë	3
<b>3.</b>	<b>Dioksidi i azotit (NO<sub>2</sub>) dhe oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>)</b>	40 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a
<b>4.</b>	<b>Plumbi (Pb)</b>	0.5 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a
			Mesatarja maksimale	

5.	<b>Monoksidi i karbonit (CO)</b>	10 mg/m <sup>3</sup>	ditore 8 orë	n/a
6.	<b>Dioksidi i Karbonit (CO<sub>2</sub>)</b>	350.00 ppm	1 vit	n/a
7.	<b>Benzeni (C<sub>6</sub>H<sub>6</sub>)</b>	5 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	n/a

**Tabela 1:** Standardet e Bashkimit Europian për cilësinë e ajrit urban

Burimi: [https://environment.ec.europa.eu/topics/air/air-quality/eu-air-quality-standards\\_en](https://environment.ec.europa.eu/topics/air/air-quality/eu-air-quality-standards_en)

Mbrojtja e cilësisë së ajrit është një përpjekje gjithëpërfshirëse dhe kërkon bashkëpunimin e autoriteteve qendrore, vendore dhe të qytetarëve. Përmirësimi i cilësisë së ajrit ka përfitime të mëdha për shëndetin dhe jetën në qytet dhe është një investim në të ardhmen e qytetit të Tiranës.

Plani i Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit do të jetë një dokument planifikimi strategjik, që mundëson zbatimin e politikës kombëtare në fushën e cilësisë së ajrit në nivel vendor. Plani do të tregojë një drejtim për të ardhmen dhe do të nxisë mendimin e përbashkët mes palëve të interesit dhe jo vetëm, që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit të masave praktike dhe veprimeve konkrete në lidhje me cilësinë e ajrit.

Plani i Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit do të jetë një dokument bazë që do të orientojë masa konkrete, afate kohore të mirëpërcaktuara, struktura përgjegjëse për zbatimin e masave si dhe buxhetet përkatëse për çdo masë, me qëllim ndërhyrjen në çdo sektor për sa i përket menaxhimit të cilësisë së ajrit në territorin e administruar nga Bashkia e Tiranës.

Plani do të hartohet në funksion të **Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit në Mjedis dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit**, dhe do të implementohet gradualisht në të gjithë fushën e veprimit të tij ku çdo faktor do të ketë detyra të qarta dhe të përcaktuara.

## 2.1 Situata Aktuale për cilësinë e ajrit në territorin e Bashkisë Tiranë

Në Planin e Veprimit “Qyteti i Gjelbër” për Bashkinë e Tiranës janë përcaktuar disa masa të cilat ndihmojnë Bashkinë e Tiranës për sa i përket situatës së cilësisë së ajrit. Por për shkak të zhvillimit të madh që ka marrë Tirana vitet e fundit, këto masa janë të pamjaftueshme. Për këtë arsye lind nevoja e hartimit të një plani vendor veprimi, i cili do të orientojë Bashkinë e Tiranës drejt marrjes së masave efektive për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Shtimi i territorit dhe popullsisë sjell rrjedhimisht rritjen e numrit të vendbanime; rritjen e përdorimit të mjeteve të transportit; rritjen e prodhimit të produkteve bujqësore e blegtorale; e padyshim që të gjithë këta faktorë ndikojnë drejtëpërsëdrejti në rritjen e ndotjes së ajrit. Për këtë arsye lind nevoja e hartimit të një Plani Veprimi për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, i cili do të adresojë të gjitha çështjet që lidhen me ajrin në periudhë afatgjatë.

Bashkia e Tiranës nëpërmjet hartimit të këtij plani synon uljen e vazhdueshme të përqëndrimit të ndotësve në ajër, përmirësimin dhe ruajtjen e cilësisë së ajrit në zonat që kanë kaluar limitet e vendosura me ligj dhe direktivave 2008/50/EC të Bashkimit Evropian për cilësinë e ajrit të mjedisit, ose zonave ku ekziston një rrezik i lartë i tejkalimit të limiteve në territorin e qytetit.

### 3. DETYRAT

#### 3.1 Detyrat që ndiqen për hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit

Monitorimi i cilësisë së ajrit që do të realizohet për një periudhë 6-mujore nga nënshkrimi i kontratës deri në përfundim të saj, për të arritur në konkluzione do të realizohen matjet muajin e 1-3-6 ( javën e parë të cdo muaji, minimumi 7 ditë kalendarike për secilin muaj).

Matjet do të realizohet në 6 pika në zonën urbane dhe në 6 pika në zonën rurale.

Detyrat që duhet të zbatohen me qëllim hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit janë:

- Grumbullimi i të dhënave dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale për sa i përket ndotjes së ajrit në territorin e Bashkisë Tiranë.
  - Plani i masave konkrete për ndërhyrje, me afate të përcaktuara, struktura përgjegjëse për zbatim si dhe kostot për zbatimin e secilës masë.
  - Përgatitja e draft-raportit të analizës së situatës aktuale.
  - Vlerësimi i faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ajrit:
- ✓ Transporti (djegia e karburanteve, trafiku i dendur)
  - ✓ Sektori i ndërtimit
  - ✓ Zhvillimi urban
  - ✓ Menaxhimi i mbetjeve
  - ✓ Bujqësia (kimikatet dhe nënproduktet e agroindustrisë)
  - ✓ Fabrikat
  - ✓ Gjelbërimi
  - ✓ Si dhe çdo faktor tjetër që ndikon në menaxhimin e cilësisë së ajrit

- Hartimi i masave që do të ndërmerren për ato zona ku ka rrezik për tejkalimin të një ose më shumë vlerave limit (kryesisht zona urbane e qytetit) dhe ruajtja e niveleve aty ku nuk janë kaluar këto vlera, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku.
- Rekomandime për masat që duhet të marrë Bashkia e Tiranës për shkarkimet nga burimet e lëvizshme (shkarkimet e mjeteve motorike, shkarkimet në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion).
- Rekomandime për masat që duhen marrë nga Bashkia Tiranë për pakësimin e shkarkimeve në ajër nga përdorimi i lëndëve djegëse (cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel).
- Rekomandime për masat që duhen marrë për alternativa të ndryshme të qarkullimit rrugor, në mënyrë që të pakësohet ndotja e ajrit.
- Hartimi masave dhe politikave vendore, për vendosjen e kufizimeve të burimeve difuze (reduktimi nga shkarkimet e trafikut) që shkarkojnë ndotës të cilësisë së ajrit.
- Hartëzimi i burimeve të ndotjes dhe krijimi i një baze të dhënash të shkarkimeve në nivel lokal në ajër.
- Masa për inkurajimin e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme për ngrohje, ftohje, ndriçim etj.
- Masa për reduktimin e shkarkimeve nga burimet pikësore (janë ato burime të mundura dhe të dobishme të merren në konsideratë në mënyrë individuale).
- Masa për implementimin e një sistemi monitorimi për cilësinë e ajrit dhe krijimi i një sistemi inventari të shkarkimeve.
- Rekomandime për masat që duhen marrë për pakësimin e shkarkimit në ajër nga burime të palëvizshme (**fermat blegtorale-rrethinat përreth qytetit, fabrikat**).
- Rekomandime për masat që duhen marrë për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë (në instalime, bojëra, dhe produkte për lustrimin e automjeteve).
- Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative, faktorët dhe aktorët që influencojnë.
- Përfshirja e çështjeve të cilësisë së ajrit në planifikimin ndërsektorial të Bashkisë së Tiranës si psh. në fushën e transportit, planifikimin e përdorimit të tokës, bujqësisë, planifikimit të territorit etj.
- Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor për menaxhimin e cilësisë së ajrit.
- Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre.
- Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të veprimit me palët e interesuara.
- Konsultimi i draft-planit të veprimit me aktorët vendimarrës (Bashkia Tiranë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë Administrative, banorët, shoqatat, fakultete etj).
- Reçensime të draft-planit të përgatitur dhe ripunim materiali pas vërejtjeve të bëra.

### 3.2 Objektivat e përgjithshme dhe specifike të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, është të përcaktojë dhe të marrë masa për përmirësimin e cilësisë së ajrit në mjedis që synojnë të shmangin, parandalojnë ose pakësojnë efektet e dëmshme në shëndetin publik dhe mjedisin në territorin e Bashkisë Tiranë.

Objektivat specifikë të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit do të jenë:

- ◆ Përputhja me Dokumentin “Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit” dhe objektivave të saj, duke kontribuar në zbatimin e politikave për parandalimin dhe marrjen e masave për përmirësimin e ndotjes së ajrit dhe në arritjen e objektivave kombëtare në nivel lokal.
- ◆ Krijimi i një kuadri për qasje të qëndrueshme të çështjeve të cilësisë së ajrit në nivel lokal.
- ◆ Përmirësimi i planifikimit urban.
- ◆ Marrja e masave për ndalimin e djegies së pakontrolluar të mbetjeve në bujqësi.
- ◆ Pakësimi i impakteve negative dhe marrja e masave për ndikimin që sjell ndotja e ajrit në mjedis, si trafiku i dendur, djegia e karburanteve, sektori i ndërtimit, bujqësia etj.
- ◆ Sigurimi i pjesëmarrjes së gjerë të popullsisë lokale në vendimarrje për menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe rëndësinë e tyre.
- ◆ Krijimi i një modeli nxitës për aktivitete ndërgjegjësuese, edukuese dhe informuese që mbështesin veprimet e uljes së ndotjes së ajrit.

#### 4. QËLLIMI I PUNËS

Grupi i punës i ngritur me Urdhrin Nr. 2212 datë 07.08.2024, datë dhe nr.15655/1 prot., datë 07.08.2024 të Zv/Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit, konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit “Hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”,

Termat e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar mbështetur në Ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar); ligjin nr. 162/2014 për "Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis", si dhe Strategjinë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit.

Këto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat për autorët që do të përgatisin Planin e Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, Bashkia Tiranë.

Hartimi i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit ka si qëllim marrjen e masave që do të ndikojnë në uljen e vazhdueshme të përqendrimit të ndotësve në ajër dhe të ruajë nivelet e cilësisë së ajrit për të siguruar shëndetin e popullsisë dhe ekosistemeve.

Hartimi i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, dhe të sigurojë një ndërveprim me aktorët dhe Bashkinë si dhe koordinim me institucionet qendrore.

#### **4.1 Fazat që ndiqen për hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit**

- a) Puna paraprake për hartimin/ndjekjen e projektit
  - b) Puna në terren
  - c) Puna në zyrë/verifikimi final i rezultateve të projektit
- **Puna përgatitore**
    - Grumbullimi i të dhënave dhe shqyrtimi i literaturës.
    - Vlerësimi i faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ajrit.
    - Përgatitja e draft-raportit të analizës së situatës aktuale.
  - **Puna në terren**



- Identifikimi i ndotësve kryesorë të ajrit që do të maten në zona specifike të paracaktuara.
  - Krijimi i një rrjeti hartëzimi i burimeve të ndotjes dhe pikave të monitorimit.
  - Identifikimi i niveleve të matjes së ndotjes në këto zona.
- **Puna në zyrë**
    - Përgatitja e një plani mbi rezultatet e marra nga matja e nivelit të ndotësve në ajër.
    - Hartimi i masave/ rekomandimeve që do të ndërmerren për zonat specifike.
    - Zhvillimi i një plan projekti për fushata sensibilizuese në zonat ku niveli i ndotjes pritet të tejkalojë pragun imit.

## **5. AFATI I HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

Për realizimin e hartimit të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit parashikohet një afat kohor 6 mujor .

Duhet të parashikohen dhe të detajohen në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar.

**Fazat që ndiqen për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit dhe afatet përkatëse, pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:**

**Grafiku i dorëzimit të Raportit përfundimtar:**

NR.	GRAFIKU SIPAS DETYRAVE	MUAJT E VITIT					
		I	II	III	IV	V	VI
1	Vlerësimi i gjendjes aktuale në lidhje me cilësinë e ajrit.						
2	Matja e cilësisë së ajrit						
3	Përcaktimi i ndërhyrjeve (masave) në sektorët përkatës me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit.						
4	Hartëzimi i burimeve të ndotjes.						
5	Përgatitja e vizionit, misionit.						
6	✓ Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të veprimit me palët e interesuara.						
7	Përfshirja e sugjerimeve të palëve të interesit në material.						
8	Përgatitja e draft-planit të veprimit duke marrë parasysh komentet nga autoriteti kontraktor dhe dorëzimi i dokumentit final.						

---

## **6. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

Bashkia e Tiranës me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak Vendimit nr. 36 datë 28.03.2024 të Këshillit Bashkiak të Tiranës për “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 125, datë 22.12.2023 të Këshillit Bashkiak për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024”, ka akorduar fondin për hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, si dhe me Urdhër të Zv/Kryetarit të Bashkisë Urdhrit Nr.2212, datë 07.08.2024, dhe nr. 15655/1 prot., datë 07.08.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit, konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit **“Hartimi i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”**”.

Në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, nga ana e autoritetit kontraktor është realizuar përllogaritja e fondit limit që do të përdoret për kontraktimin e subjektit/eve që do të hartojnë Planin e Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit.

Fondi limit në total për hartimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit është përllogaritur në vlerën e **14,766,667** (katërmëdhjetë milion e shtatëqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqindë e gjashtëdhjetë e shtatë ) lekë me TVSH dhe **12,305,556** (dymbëdhjetë milion e treqindë e pesë mijë e pesëqindë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

## **7. MONITORIMI I DETYRAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

Autoriteti kontraktor do të monitorojë realizimin e detyrave të ndryshme të hartimit të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit dhe punimet që realizohen nga subjekti i kontraktuar nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

Grupi i monitorimit do të ketë në përbërje 3 specialistë nga Drejtoria e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Emergjencave Natyrore, pranë Bashkisë Tiranë, të cilët do të monitorojnë

---

procesin e hartimit të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit nga subjekti i kontraktuar në lidhje me:

- ✓ Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në përgjithësi;
- ✓ Përbushjen e kërkesave për punimet e terrenit dhe ato të zyrës;
- ✓ Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në lidhje me numrin e punonjësve dhe kualifikimet profesionale të stafit të përfshirë në proces nga kontraktori;
- ✓ Respektimin e kritereve tekniko-ligjore nga kontraktori gjatë procesit të hartimit të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit;
- ✓ Zbatimin e afateve kohore për realizimin e fazave dhe aktiviteteve nga kontraktori të përcaktuara paraprakisht;
- ✓ Detyrime të tjera të kontraktorit.

Grupi i monitorimit gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara, njofton me shkrim titullarin e autoritetit në lidhje me problematikat që konstaton gjatë procesit të hartimit të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit si dhe sugjeron masat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale dhe tekniko-ligjore nga ana e kontraktorit.

## **8. MIRATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT**

Plani i Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, pasi ti nënshtrohet konsultimit me aktorët e fushës (Nj.A. shoqatat, komunitetit) do të dërgohet për miratim në Këshillin Bashkiak të Tiranës e më pas dërgohet zyrtarisht për konfirmim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

## **9. REFERENCA LIGJORE**

Gjatë përgatitjes së këtij materiali, janë mbajtur në konsideratë detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e menaxhimit të cilësisë së ajrit

Kuadri ligjor përkatës përbëhet nga:

- ✓ Ligji Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis”;
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 594, datë 10.9.2014 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit”;
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 412, datë 19.6.2019 “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”;

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 162, datë 19.2.2020 “Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër;
- ✓ VKM nr. 154, datë 27.2.2019“Për disa ndryshime në vendimin nr. 633, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”;
- ✓ Vendim Nr. 352, datë 29.4.2015 “Për Vlerësimin e Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të;
- ✓ Vendim Nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër”;
- ✓ VKM Nr. 907, datë 21.12.2016 “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshën nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve;
- ✓ Ligji nr. 9425, datë 6.10.2005, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe”;

Nr	Emërtimi/Përshkrimi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Vlera
<b>I.</b>				
1.1	Hartim i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit	1		
<b>Çmimi NETO</b>				
<b>TVSH 20 %</b>				
<b>Çmimi TOTAL</b>				

Punoi: Grupi i punës ngritur sipas të Zv/Kryetarit të Bashkisë Urdhrit Nr. 2212, datë 07.08.2024, dhe nr. 15655/1 prot., datë 07.08.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit, konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit “**Hartimi i Planit të Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit**”.

---

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e

---

drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

---

c. **DEKLARATË Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit sipas Shtojcës 5;**

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.2** Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021,2022,2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10. *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.



---

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) **ISO 9001:2015** (ose e përditësuar) - për “Sistemin menaxhimin e cilësisë”;
- b) **ISO 14001:2015** (ose e përditësuar) - për “Menaxhimin e mjedisit”;
- c) **ISO 45001:2018**(ose e përditësuar)- për “Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”
- d) **ISO 4225:2020** (ose e përditësuar) – “ Për cilësinë e ajrit”;

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin e specializuar të profileve si më poshtë:

